



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DHE EKONOMISË
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

KOMISIONI I ANKIMIT TË ISHPSHSH-SË

Nr. 2945/4 Prot.

Tiranë, më 24/12.2022

Lënda: Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së

SHOQËRISË : SHOQËRISË: “VACLEAN ALBANIA”, ME NIPT L51627504D

Adresa: Lagja “Skenderbeg” Rruga Treni i Mallrave

Shkodër

Për dijeni: DREJTORISË RAJONALE TË ISHPSHSH-së, RAJONI V, SHKODËR

Bazuar në pikën 2 të nenit 51 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ankimimit për vendimin përfundimtar Nr.ISHPSHSH-SH-2022-000568-5, datë 17.11.2022, të subjektit “Vacleam Albania” sh.p.k, Komisioni i Ankimit, i ngritur pranë ISHPSHSH-së, pasi shqyrtoi kërkesën tuaj ankimore për masën administrative kryesore “gjobë” në vlerën 340 000 (treqind e dyzet mijë) lekë, për shkelje të dispozitës ligjore që përcaktohet në nenin 11 pika 3 të Ligjit nr.9163, datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të procesverbalit të mbajtur gjatë mbledhjes së komisionit:

VENDOSI:

1. **Lënie në fuqi** të vendimit përfundimtar Nr.ISHPSHSH-SH-2022-000568-5, datë 17.11.2022 duke lënë në fuqi dënimin administrativ gjobë në vlerën 340 000 (treqind e dyzet mijë) lekë si dhe refuzimin e ankimimit.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas legjislacionit në fuqi.

